SBASHK
Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures
Kultura e njeriut
É-buletin

Arsimimi sot

Tetor,2014

Fjala e redaksisë

Lexues të nderuar të gazetës elektronike “Arsimimi sot”, ju përshëndesim dhe ju ftojmë që të lexoni numrin më të ri të gazetës sonë. Edhe muaji Tetor ishte me plotë aktivitete të ndryshme sindikale, prandaj përmes kësaj gazete, po përpiqemi që t’i paraqesim ato, në mënyrë që të jemi më afër jush. Si gjithnjë edhe kësaj radhe ju presim të na shkruani për ndonjë aktivitet të veqantë që ju keni pasur gjatë muajit përkatës, në mënyrë që shkrimet e juaja të jenë pjesë e numrit tonë të radhës. Shëndet e suksese në punë.

Apel Presidentes së Kosovës: Vepro Presidente, qoftë edhe me zgjedhje të reja

12.10.2014-Ngërçi politik po ndikon edhe në sektorin e arsimit. Për këtë, Sindikata e Bashkuar e Arsimit dhe Shkencës dhe Kulturës, (SBASHK), i ka bërë apel presidentes së Kosovës, Atifete Jahjagës, për zgjidhjen e këtij ngërçi, qoftë ajo edhe me anë të zgjedhjeve të reja.

Në një njoftim të dërguar nga Rrahman Jasharaj, kryetar i SBASHK-ut, në shumë drejtori të komunave të arsimit, po e shfrytëzojnë situatën e krijuar në Kosovë, dhe janë duke vepruar ashtu siç ju konvenon atyre.

“Presidente ne kemi nënshkruar Kontratën Kolektive me MASHT-in dhe pjesa dërmuese e saj ka qenë dashur të vihej në jetë nga dita e nënshkrimit, por janë shumë DKA që shfrytëzojnë këtë situatën momentale dhe bëjnë e veprojnë ashtu si u teket. Aq më shumë ne jemi plot stres sepse në janarin e vitit 2015 duhet të implementohen edhe 4 pikat, që nuk janë realizuar këtë vit, me marrëveshjen dy paleshe, për arsye se nuk kishte mjete. Jemi marrë vesh që planifikimi buxhetor të bëhet nga institucionet lokale e qendrore dhe të jemi të gatshëm që t'u dalim në fjalë mësimdhënësve, por kështu si është puna tani kur liderët nuk merren vesh dot kemi frikë se janari do të na sjellë shume probleme e pakënaqësi që do të nxisin situatën në arsim drejt një greve të madhe e të përgjithshme”, thuhet në një deklaratë për media nga SBASHK-u.

Sipas zyrtarëve të SBASHK-ut në këtë deklaratë janë cekur vetëm një pjesë e vogël e shqetësimeve dhe problemeve që pjesa e madhe e të punësuarve në arsim, po kërkon përgjigje.Kryetari Jashari, në emër të SBASHK-ut, i kërkon presidentes, që të marr një vendim për krijimin e institucioneve.

“Veproni e nderuara presidente dhe duke e parë se liderët nuk po dëgjojnë të merren vesh, atëherë le t'i japim mundësi popullit ta thotë fjalën e mendimin e tij përmes zgjedhjeve të reja. As kështu nuk është mirë, por mbase kjo do të hapte rrugë e do të krijonte kushte për krijimin e institucioneve. Presidente koha nuk pret, bile Kosova është vonuar”, vijon më tutje në deklaratë.

Delegacioni i SBASHK-ut u takua me Ministrin Nenad Rashiq

Ata kërkuan që z.Rashiq mos ta nënshkruaj përbërjen e re të Këshillit Ekonomiko-Social

Ministri i MPMS-së, z. Nenad Rashiq është takuar me delegacionin e SBASHK-ut. Temë e bashkëbisedës ka qenë propozimi i një komisioni vlerësues për përbërjen e re të Këshillit Ekonomiko-Social.

Delegacioni i SBASHK-ut ka ripërsëritur në takimin me ministrin Rashiq se kjo Sindikatë, që konsiderohet nga më aktivet dhe më të organizuarat në Kosovë, nuk njeh raportin e një Komisioni, ngase ai është përbërë nga njerëz të subjekteve konkurruese për anëtarë të KES-it.

"Që nga publikimi në media të propozimit të një Komisioni vlerësues lidhur me përbërjen e re të Këshillit Ekomomiko-Social , SBASHK-u ka shprehur pakënaqësitë lidhur përbërjen e këtij Komisioni ngase në të nuk kishte pjesëmarrës të pavarur, por ishin përfaqësues të palëve konkurruese për KES, gjë që paraqet konflikt interesi. Përbërjen që ofron ky Komision nuk e njohim dhe prandaj apelojmë të Ju z. Ministër që të mos e nënshkruani këtë raport e as përbërjen e re të KES-it", është shprehur në bisedë me Ministrin Rashiq, kryetari i SBASHK-ut, z.Rrahman Jasharaj.

Anëtari tjetër i delegacionit të SBASHK-ut, z.Ymer Ymeri, ka ofruar mjaft fakte dhe ka treguar se SBASHK-u ka ofruar dokumentacion valid që dëshmon për numrin e saktë të anëtarëve. Ai është shprehur se në momentin aktual kur BSPK-ja, është Konfederatë , por nuk ka numrin e paraparë të anëtarëve sipas Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social, se në përbërjen e saj nuk janë sindikatat më të fuqishme të Kosovës dhe se në Komisionin vlerësues për përbërjen e re të KES-it ka konflikt interesi, është e udhës që Ministri të mos e nënshkruaj përbërjen e KES-it si e ka propozuar ai komision, por të takohet me sindikatat që kanë konkurruar dhe të gjendet një zgjedhje me marrëveshje nga të gjithë. Ministri Rashiq ka deklaruar se është për respektim të Ligjeve, duke mos i dhënë ndonjë përgjigje të prerë delegacionit të SBASHK-ut. Ata kanë deklaruar edhe një herë në përfundim të këtij takimi se nuk do ta njohin përbërjen e KES-it pa qenë të përfaqësuara aty sindikatat më të forta e me anëtarësi reale dhe se do të vazhdojnë me përpjekjet për të triumfuar drejtësia, që konsiderojnë se është në anën e tyre.

SBASHK-u takohet me rektorin Prof. Dr. Ramadan Zejnullahu

Një delegacion i SBASHK-ut, i kryesuar nga kryetari Rrahman Jasharaj, kanë qenë mysafirë në Rektoratin e UP-së. Atje janë pritur nga Rektori, Dr. Prof. Ramadan Zejnullahu, i cili ka njoftuar këtë delegacion për angazhimet e këtij Institucioni të rëndësishëm në shërbim të mirëvajtjes së punës në këtë Universitet. Rektori ka përmendur edhe sfidat, të cilat, si tha ai, me punën dhe përkushtimin e gjithë të punësuarve në këtë Institucion me rëndësi të veçantë për arsimin e Kosovës , do të tejkalohen dhe do të shënohen arritje të reja.

Kryetari i SBASHK-ut z.Rrahman Jaharaj bashkë me anëtarët e delegacionit Bardh Bardhi , kryetar i SUSHK-ut ,Ymer Ymeri dhe Vlora Rexhepi e kanë përgëzuar Rektorin për detyrën dhe i kanë shprehur gatishmërinë për bashkëpunim të sinqertë e korrekt në shërbim të mirëvajtjes së punës në këtë Institucion të Lartë të Arsimit.

Kryetari i Sindikatës së Universitetit (SUSHK), që është pjesë përbërëse dhe shumë e organizuar e SBASHK-ut, z. Bardh Bardhi i ka treguar Rektorit për rrjedhat e veprimtarisë sindikale në Universitet dhe veçmas është ndalur te angazhimet për Kontratën e re Kolektive për Universitetin, që pritet të nënshkruhet së shpejti nga të dy palët, pasi që teksti final i saj është harmonizuar në tërësi.

Rektori, Dr. Prof. Ramadan Zejnullahu dhe delegacioni i SBASHK-ut janë shprehur të gatshëm për takime pune dhe për bashkëpunim korrekt gjatë gjithë kohës e në shërbim të mirëvajtjes së punës në këtë Institucion të Lartë të Arsimit të Kosovës.

Paralajmërim publik i kryetarit të SBASHK-ut

Artan Mjekiqi kërko nga mësuesit tuaj hiena fakte për akuzat se do të përballemi në gjykatë.

Të premten teksa po kthehesha nga takimet me DKA-të në Drenas e Skenderaj lidhur me kontratat individuale e Kontratën Kolektive dhe teksa po ndanim gëzimin me delegacionin tonë lidhur me marrëveshjen e 35-të me bizneset e në shërbim të sindikalistëve, disa media me telefonuan dhe më njoftuan se 6 persona qenkan mbledhur për të formuar “sindikatë të re”.

Nuk u befasova edhe shumë dhe e dita se është kjo edhe një lojë e hienave. Kur pash se kush ka marrë këtë detyrën e kryegënjeshtarit tani më iku tërë stresi. Ky na qenka njëfarë Artan Mjekiqi, që në Universitet erdhi para një viti si tezak dhe shofer i dikujt. Ky farë Mjekiqi u mundua të dal sheshit me “muskuj” e me zhurma një grevë të një pjese të administratës .

Ne kishim ndërhyrë atje për të mos dalë situata jashtë kontrollit sepse greva e Mjekiqit ishte shpallur ngutazi e pa u bazuar në Ligjet e rregullat. Mjekiqi kishte marrë detyrë nga mësuesit e tij dështak Rashit Maliqi e Nezir Gashi që të shfrytëzojë situatën dhe ta rrënojë fillimisht Sindikatën e Universitetit (SUSHK-un) dhe drejtuesit e saj legjitim e pastaj të vazhdojë me rrënimin e SBASHK-ut. Kur Mjekiqi në SBASHK mori përgjigjen e merituar se kurrën e kurrës nuk do të rrënojmë organe legjitime, ai doli sheshit dhe kërkoi letra nga mësuesit e tij, që në shumë institucione i përzunë pasi kishin shkuar të përhapnin gënjeshtra kundër SBASHK-ut.

Artan Mjekiqi mori rolin që të të bëhet zëdhënës i Rashitit e Nezirit, që janë zhveshur e kanë mbetur pa fijen e autoritetit sindikal në terren, dhe bëri bashkë 6 persona për ta shpallur “lajmin” e madh se u formuaka një “sindikatë” e re. I gjori Artan është mashtruar se nuk u ul të punojë një letër për mediet nga koka e tij, por u besoi mësuesve nxitësve të tij Rashitit dhe Nezirit dhe e mori tekstin e gatshëm të tyre, që ishin munduar ta plasojnë tani e sa kohë e me ato gënjeshtrat e tyre. Artani plasoi letrën e dështakëve dhe u mundua të bëj bujë më rrenat.

Asnjë gënjeshtër e re nuk doli. Artani u besoj shumë Rashit Maliqit e Nezir Gashit, që tani devijojnë rrugën kur shohin se andej po vjen ndonjë mësimdhënës se frikësohen nga pështyma e tyre. Tani Artanin e gjeten që të bëhet servis i gënjeshtrave dhe shpifjeve ndaj SBASHK-ut dhe veprimtarëve sindikalistë.

Tani unë po të lajmëroj me kohë, se nuk godas në mënyrë qyqare e tinëzare. Artan Mjekiqi lexoje edhe një herë letrën plot gënjeshtra që ta kanë lënë në dorë Rashiti e Neziri. Kërko nga ta të të gjejnë argumente për t’u mbrojtur se do të përballemi para drejtësisë. Gjykata do të kërkoj nga ti argumentet, që nuk i ke, e unë do të kërkoj nga gjykata të triumfojë e vërteta dhe do të kërkoj dëmshpërblim për tendencat tuaja qyqare për të lënduar autoritetin tim dhe të Sindikatës, që është më e forta dhe më e respektuara, jo vetëm në Kosovë. Shiko a po të dalin si dëshmitarë para trupit gjykues mësuesit tuaj hiena Rashit Maliqi e Nezir Gashi.

I gjori Artan, sa i takon gënjeshtrës se je duke formuar sindikatë të re s’kam çfarë të të them. Kështu kishin deklaruar para disa muajve edhe mësuesit tuaj Rashiti e Neziri, por doli se është gënjeshtër. Artan në SBASHK çdo ditë po vijnë anëtarë të ri. Po vijnë sepse e kanë kuptuar se SBASHK-u është sindikata i tyre që bashkëbisedon me ta, që është e pastër dhe që mundohet të realizojë misionin e saj. Artan në bregdet do të më shihni edhe në të ardhmen sepse Këshilli i Evropës në bashkëpunim me KEC e me SBASHK-n po realizojnë një projekt në shërbim të forcimit të vazhdueshëm të SBASHK-ut. Miqtë po na trajnojnë e po na dërgojnë në seminare edhe në det o Artan se na besojnë dhe e dinë kush jemi. SBASHK-u nuk po harxhon as edhe një cent për këto seminare o Artan. Ty të kanë informuar gabimisht edhe për këtë. Ajo që ke thënë ti po del se është gënjeshtër dhe përgatitu edhe për këtë para gjyqit.

Rrahman Jasharaj,
Kryetar i SBASHK-ut

Takim i suksesshëm i SBASHK-ut në Suharekë

Prishtinë, 28.10.2014-Në vazhdën e takimeve me DKA-të, delegacioni I SBASHK-ut, në përbërje nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe menaxheri financiar Ymer Ymeri, kanë vizituar Suharekën.

Ata fillimisht janë takuar me kryetarin e kuvendit të SAF dhe SAM të kësaj komune, z.Sadik Shala për të vizituar pastaj bashkërisht DKA-në në Suharekë. E veçanta e këtij takimi ishte se drejtori DKA-së z.Sherif Berisha, kishte ftuar në takim edhe zyrtarë përgjegjës, si drejtorin për financa z.Hasan Gashi dhe drejtoreshën e zyrës ligjore znj.Halime Gashi. Drejtori Berisha ka lavdëruar bashkëpunimin e drejtorisë që drejton me sindikatën e arsimit në Suharekë. Ai është shprehur i gatshëm të bashkëpunoj edhe në të ardhmen për arsimin në këtë komunë.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë përgëzuar DKA-në e Suharekës për angazhimet dhe në bashkëbisedë me ta kanë treguar se SBASHK-u viziton DKA-të që bashkërisht të mbrojnë Kontratën Kolektive.

Ata dhe këtu kanë kërkuar që të bëhen planifikime buxhetore për implementimin e plotë të Kontratës Kolektive. DKA-ja në Suharekë është pajtuar me këtë propozim, duke shtuar se do të vazhdoj bashkëpunimin me SBASHK-un edhe në të ardhmen në shërbim të arsimit.

Shqetësim i përbashkët ishte se edhe në këtë komunë hetohet rënie e numrit të nxënësve.

SBASHK-u nuk pranon përbërjen e re të Këshillit Ekonomik-Social (KES)

SBASHK-u ka deklaruar publikisht që nuk e pranon përbërjen e re të Këshillit Ekonomik-Social (KES) e as vendimet e tij dhe ka ofruar mjaft argumente për këtë. Lidhur me qëndrimin e vet SBASHK-u ka dërguar letra kabinetit të Kryeministrit, MASHT-it dhe MPMS-së dhe instancave tjera.

"Kemi pritur që MPMS-ja do të na kthej një përgjigje sepse jemi Sindikata më e madhe dhe më aktivja në Kosovë. Pasi nuk ka marrë as edhe një përgjigje kjo sindikatë që nga 1 tetori ka bërë përpjekje të takohet me ministrin Rashiq duke i dërguar kërkesë me shkrim e duke tentuar që përmes përgjegjësve të kabinetit të tij të pajtohemi për një datë dhe për një takim të shkurtër konsultativ. Ministri Rashiq ishte vazhdimisht i zënë e me shumë angazhime dhe ne këtë e kuptojmë, por nga 1 tetori e deri sot është dashur të gjejë pesë minuta edhe për ne."

"Ministri Rashiq Ju do të vazhdoni të jeni i zënë dhe në pamundësi që të na takoni, ne po Ju drejtohemi publikisht me kërkesën që të mos e nënshkruani përbërjen e re të Këshillit Ekonomik-Social sepse me përbërjen e propozuar nga Komisioni, që nuk është dashur të jetë në atë përbërje, gjithë interesat dhe kërkesat e shumta të punëtorëve të arsimit dhe të sektorëve të tjerë nga shërbimet publike, do t’i “mbrojnë” 5 të deleguar nga BSPK-ja. Kjo nuk është e pranueshme për ne z.Ministër."

"Ne jemi sindikata me më së shumti anëtarë dhe përfaqësojmë një sektorë tepër të rëndësishëm dhe me plot zhvillime e halle. Ministria e Arsimit është në KES si përfaqësuese e Qeverisë. Pse të mos jemi edhe ne aty kur i gjithë dialogu social për arsimin, kryesisht, zhvillohet në relacionin MASHT-SBASHK e vend më të qëlluar për këtë dialog nuk ka se në takimet e KES-it."

"I nderuari Ministër Rashiq pasi Ju nuk keni kohë të lirë për t’u ballafaquar me këto vërejtje, urojmë që vartësit tuaj në MPMS ta lexojnë të publikuar këtë kërkesë tonën dhe me rastin kur do të gjeni disa minuta dhe do të nxirrni lapsin duke dashur ta nënshkruani përbërjen e re të KES , ata do t’u tregojnë se, jo vetëm SBASHK-u, por edhe Sindikata e Shëndetësisë, e Policisë dhe të tjera Sindikata janë kundër përbërjes së KES-t me 5 përfaqësues nga BSPK-ja e me as edhe një përfaqësues nga sindikatat më të forta e më aktive të Kosovës."

"Ministër Rashiq mos e nënshkruaj përbërjen e re të KES-it pa gjetur pak kohë të takohesh me përfaqësues të SBASHK-ut dhe të Sindikatave tjera që kanë reaguar", thuhet në fund të letrës.

Marrëveshje të shumta në shërbim të mësimdhënësve sindikalistë të Klinës

Angazhimet e vazhdueshme të SBASHK-ut në nivel qendror dhe të veprimtarëve të saj nëpër komuna kanë gëzuar përkrahjen e miqve të arsimit. Kjo po vërehet edhe në Komunën e Klinës. Atje falë angazhimit të Kryetarit të SAF e SAM z. Arif Elezaj, të nënkryetarit z. Islam Kalludra dhe veprimtarëve të tjerë janë arritur shumë marrëveshje.

z. Elezaj shpreh respekt për disa nga bizneset në Klinë. “Këta njerëz na kanë pritur ngrohtësisht dhe duke shprehur respektin për misionin e shenjtë të mësimdhënësve nëpër vite e dekada i janë bashkëngjitur veprimtarisë sonë që të jeni në shërbim të mësimdhënësve sindikalistë”, shprehet me entuziazëm Arifi, për të dëshmuar pastaj marrëveshjet e arritura me fakte e me foto nga ceremonitë solemne të nënshkrimit të tyre.

Me dëshirë që t’u ndihmojmë anëtarëve të SBASHK-ut në Komunën e Klinës po botojmë informacione për Marrëveshjet e nënshkruara të shoqëruara me foto.

Marrëveshjet – kontratat e arritura ne mes Sindikatës se Arsimit të Klinës dhe ndërmarrjeve tregtare-private :

1. NTP “Pre-Market” Klinë me këtë përqindje
Gjëra ushqimore me zbritje nga çmimi i përgjithshëm 3% si dhe për të gjitha mallrat tjera me këtë përqindje.
2. Barnatorja “Ariana”, sheshi Nëna Terezë-Klinë,me zbritje nga çmimi i përgjithshëm prej 10%
3. Ina “Baci Petrol” –në dalje të Klinës, rrugës për në Zllakuqan, me këtë zbritje te përqindjes : Për derivate (naftë dhe benzinë) 2centë për litër, për produkte tjera në depo 2% dhe për restaurant 5%.
4. Poliklinika “Biolab-Zafi” që gjendet te spitali Nëna Terezë, me zbritje të kësaj përqindjeje: Vizita mjekësore specialistike 20%, shërbimet laboratorike 25%,intervenimet e vogla kirurgjike 20%, ultrazëri 20%, EKG 20%.
5. NTT “Semirra” –Klinë ,me zbritje të kësaj përqindjeje: për gjëra ushqimore 3%, konfeksione (rroba) 5%, për mobilieri 5,10 dhe 15%.
6. Kompania “Benita” në Gremnik ,me këtë zbritje: Për të gjitha llojet e zallit 5%, për beton 3%.
7.OSI "Driloni-Med" me seli ne Kline,me drejtorin Dr.Haxhi Ibishi infektolog eshte nenshkruar kontrata per te gjitha sherbimet mjekesore me zbritje prej 50%
8. OPS "Dental" -Kline e perfaqesuar nga drejtoresha Dr.Have Ademi stomatologe me perqindje per te gjitha sherbimet mjekesore dentale prej 10%.
9. Barnatorja "Doni Farmaci" -Kline drejtoreshe Edita Gashi eshte arritur marreveshja per te gjitha furnizimet me te gjitha ilaqet me zbritje prej 10%.
10. Salloni i autopjeseve "Doruntina" - Kline drejtori Fehmi Raci me zbritje prej 5%.

SBASHK-u përgëzon për këto arritje veprimtarët sindikalë në Klinë dhe në komunat tjera të Kosovës që po punojnë në shërbim të anëtarësisë. Ju lumtë.

Po ashtu edhe në komunën e Gjakovës dhe Gjilanit janë arritur këto marrëveshje:

1. Ndërmarrja "Nertili", Gjakovë, perfaqesuar nga z.Lulzim Zeka, ofron sherbime ne blerje te mallrave ushqimore dhe jo ushqimore me zbritje prej 5%
2. Ordinanca "Dafota Dent", Gjakove, perfaqesuar nga Dr.Nafi Dafota, ofron sherbime mjekesore te sferes se kesaj ordinance me zbritje prej 20%
3. Objekti hotelier turistik “**Besani**” & “**Ballkan2**”,Durrës, e perfaqesuar nga z.Sibush Haziri nga Zhegra, ofron sherbime si akomodim dhe sherbime tjera hoteliere me zbritje prej 20%. Kjo marrëveshje është arritur përmes kryetarit të SAF dhe SAM Gjilan, z.Blerim Mehmeti.

SBASHK-u vizitoi Drenasin dhe Skenderajn

Në kuadër të aktiviteteve për të bërë një bashkëpunim dhe bashkëveprim në DKA-të e Kosovës lidhur me respektimin e Kontratës Kolektive, delegacioni i SBASHK-ut, ka vizituar Drenasin dhe Skenderajn. Delegacioni në përbërje: kryetari z.Rrahman Jasharaj, anëtari i kryesisë z.Hajriz Berisha dhe menaxheri financiar z.Ymer Ymeri, fillimisht janë takuar me drejtorin e DKA-së në Drenas,z.Sadik Tahiraj.

Drejtori i arsimit në Drenas, ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe ka lavdëruar bashkëpunimin korrekt mes DKA-së dhe sindikatës së arsimit në Drenas. Të dy palët janë pajtuar që të bëjnë angazhime te përbashkëta për ta vënë në jetë Kontratën Kolektive.

Shqetësimi i përbashkët është që kudo në komunat e Kosovës vërehet një rënie e numrit të nxënësve por është zotim i përbashkët që me një planifikim me kohë nuk do të ketë asnjë mësimdhënës të mbetur pa punë.

Ky delegacion bashkë me kryetarin e SAF dhe SAM te Skenderajt z.Ramiz Polaci kanë vizituar DKA-në e Skenderajt dhe janë takuar me drejtorin z. Jashar Lushtaku.

Takimi është përshkruar me një bashkëbisedë korrekte dhe te dy palët kanë bërë një analizë të arritjeve të arsimit të kësaj komune

SBASHK-u mori pjesë në Konferencën për Procesin e Referencimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve

Më 17 tetor 2014, përfaqësues të SBASHK-ut, kryesuar nga kryetari z.Rrahman Jasharaj ishin prezent në një Konferencë, organizuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve(AKK) në hotel Emerald.

Disa nga temat e sesioneve në këtë Konferencë janë:
Procesi i Referencimit – znj.Tetua Danuza (AKK);
Zhvillimi dhe Implementimi i Kornizave të Kualifikimeve nëpër BE – Z.John Hart (ekspert ndërkombëtar);
Themelimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve të Mbretërisë së Bashkuar – z.Trevor Clark(ekspert ndërkombëtar);

Në këtë Konferencë pjesëmarrës janë edhe përfaqësues nga MASHT, MPMS,OEK, drejtorë shkollash etj.

SBASHK-u është i përkushtuar të marr pjesë në të gjitha takimet ku flitet për arsimin, me qëllim që të jap kontributin e tij.

SBASHK-u nënshkroi marrëveshje me Kolegjin e Menaxhmentit Internacional “Globus”

Në një atmosferë festive kryetari i SBASHK-ut , Rrahman Jasharaj dhe Rektori i Kolegjit të Menaxhmentit Internacional “Globus” , prof. Dr. Nazmi Mustafa kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, e cila u mundëson anëtarëve të SBASHK-ut dhe familjarëve të tyre studime Bachelor dhe Master me zbritje prej 10%. “Kjo marrëveshje është produkt i mirëkuptimit dhe respektit të stafit udhëheqës të Kolegjit “Globus” për punën dhe angazhimet e deritashme të mësimdhënësve sindikalistë në shërbim të arsimit në Kosovë”, thuhet, veç tjerash, në këtë marrëveshje. Rektori i këtij Kolegji, prof. Dr. Nazmi Mustafa ka kujtuar pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje se sindikatat në përgjithësi, por veçmas ajo e Arsimit ka rëndësi të madhe dhe se ajo duhet të vazhdojë me angazhimet në shërbim të

arsimit cilësor dhe të jetë vazhdimisht zë i të punësuarve në arsim. Ai ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe arritjet duke u shprehur i gatshëm për bashkëpunim të vazhdueshëm .

Kryetari i SBASHK-ut z. Jasharaj ka falënderuar rektorin z.Mustafa për marrëveshjen dhe pastaj ka njoftuar atë për angazhimet dhe arritjet e kësaj sindikate në shërbim të anëtarëve të saj duke cekur se veç angazhimeve të përditshme në mbrojtjen e të drejtave dhe realizimin e kërkesave legjitime, SBASHK-u ka arritur me veprimtarët e saj kudo në Kosovë të nënshkruaj 30 marrëveshje në shërbim të anëtarësisë dhe se ky numër sa vjen e shtohet.

Edhe një seminar me rëndësi të veçantë

Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave në arsim

Me qëllim që të mos jetë vëzhgues pasiv i rrjedhave e veprimeve në emër të arsimit, po të bëhet akter i fuqishëm e domethënës në hartimin e politikave në arsim, është mbajtur seminari i radhës në kuadër të Projektit të përbashkët mes KEC-it e SBASHK-ut e që mbështetet nga Këshilli i Evropës.

E veçanta e seminarit ishte se përfaqësues sindikalë dhe 4 drejtorë nga shkollat më të mëdha të komunave të Kosovës u trajnuan për të analizuar politikat aktuale në arsim dhe për të qenë të gatshëm të ndërtojnë kapacitete për hartimin e politikave që janë në shërbim të arsimit, mësimdhënësve, nxënësve dhe ngritjes së cilësisë në arsim.

Në hapje të këtij seminari kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka lavdëruar bashkëpunimin mes KEC-it dhe SBASHK-ut e po ashtu ka përgëzuar kryetarët e niveleve komunale të Sindikatës për përzgjedhjen kaq të qëlluar të pjesëmarrësve. " Ky seminar do të jetë i suksesshëm sepse këtë e garanton përzgjedhja e qëlluar. Ju këtu jeni dëshmia më e mirë se SBASHK-u vazhdon ta shtrijë aktivitetin duke përfshirë në aktivitete anëtarë sindikalistë nga të gjitha komunat e Kosovës, por edhe drejtorë e pedagogë. Le të jetë detyrë jona këtu që në fund të seminarit ta kemi një dokument që do të ndihmojë në krijimin e politikave të favorshme arsimore për të punësuarit në këtë sferë kaq të rëndësishme", është shprehur kryetari i SBASHK-ut.

Trajnerët Alejtin Berisha dhe Burim Ejupi që në fillimet e seminarit kanë arritur të krijojnë një atmosferë korrekte e të relaksuar dhe prandaj i tërë aktiviteti është zhvilluar në formë të bashkëbisedës dhe përgjigjet e mendimet janë dhënë lirshëm, por shumë me korrektësi, nga pjesëmarrësit. Pjesëmarrësit gjetën përgjigje në pyetje me rëndësi se çfarë janë politikat publike, cili është cikli i hartimit të tyre, si qëndron rajone me këtë çështje, cilat janë procedurat dhe proceset për hartimin e këtyre politike? Janë këto vetëm disa nga pyetjet, por që më shumë janë edhe sfida e që u duhet gjetur përgjigja e zgjidhja nga pjesëmarrësit e këtij seminari. Pjesëmarrësit e këtij seminari kanë lavdëruar bashkëpunimin mes KEC-it dhe SBASHK-ut dhe po ashtu kanë fjalë të mira edhe për pronarin Beqir Novalliu dhe stafin e hotelit "Nacional" .

Trajnerët Alejtin Berisha dhe Burim Ejupi kanë shprehur kënaqësinë që anëtarët e SBASHK-ut nga shkollat më të mëdha të Kosovës vazhdojnë me angazhimet dhe me kontributin e tyre në realizimin e temave që kanë të bëjnë me hartimin e politikave arsimore. E bukura e këtij seminari ishte se ai kishte rrjedhë të natyrshme dhe forma e punës përmes bashkëbisedës dhe trajtimit të temave në mënyrë të përkushtuar ka bërë që pjesëmarrësit të këmbejnë mendime e ide se si duhet ngritur fuqinë e SBASHK-ut për të qenë hartues me zë të politikave arsimore. Trajnerët Berisha e Ejupi këtë rol të SBASHK-ut e shohin me të lehtë duke u nisur nga fakti, si thanë ata , se kjo Sindikatë e mësimdhënësve të Kosovës me punë e përkushtim ka krijuar emër të nderuar dhe një unitet për lakmi . Këto dy komponentë janë të rëndësishme në dialogun social, por edhe në angazhimet për të qenë të pranishëm kudo diskutohet , por edhe përgatiten Ligje, jo vetëm nga sfera e arsimit.

Vlen të theksohet se shumë nga pjesëmarrësit kanë dhënë vlerësime për angazhimet e SBASHK-ut, por edhe për sfidat që e presin sindikatën e tyre, ndërsa kryetari Rrahman Jasharaj dhe menaxheri i financave, Ymer Ymeri kanë dhënë sqarime për Kontratën dhe për përpjekjet e vazhdueshme të SBASHK-ut për të qenë në hap me kohën dhe për t'u marrë me kohë me problemet dhe zgjidhjen e tyre. Pjesëmarrësit në këtë seminar nga e gjithë Kosova në kuadër të aktiviteteve e seminarit shtruan edhe pyetje konkrete që kanë të bëjnë me çështje nga komunat e tyre duke marrë përgjigje për të gjitha çështjet e shtruara.

Dhe kështu në përfundim të seminarit arritëm të nxjerrim një dokument për fuqizimin e SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore, dokument ky që do të jetë një pikënisje e mirë për aktivitetet në të ardhmen.

SBASHK-u mori pjesë në një tryezë sindikale në Tiranë

U mbajt Tryeza Sindikale " Vizioni dhe angazhimi i Sindikatave të Arsimit për arsim cilësor" Sindikatat e Arsimit të Shqipërisë, të mbështetura nga EI-ja, kanë organizuar në Tiranë një tryezë të suksesshme Sindikale me temën bosht "Sindikale " Vizioni dhe angazhimi i Sindikatave të Arsimit për arsim cilësor". Krahas veprimtarëve sindikal të arsimit nga e gjithë Shqipëria, në këtë Tryezë kanë marrë pjesë edhe zëvendësministret Nora Malaj dhe Genta Sula. Mysafirë të veçantë në këtë aktivitet ishin edhe delegacioni i SBASHK-ut dhe Këshilltari i Lartë në Ambasadën e Kosovës në Shqipëri, z. Esat Brajshori, i cili ka ftuar SBASHK-un që gjatë vizitave të radhës në Shqipëri të kontaktojë me Ambasadën tonë këtu dhe t'i vizitojnë ambientet e saj.

Në fjalën e hyrjes kryetari i FSASH, z. Xhafer Dobrushi ka treguar për angazhimit e sindikatave shqiptare në shërbim të arsimit shqiptar duke u ndalur në arritjet, por edhe në sfidat. Ai ka lavdëruar komunikimin korrekt me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit , me atë Mirëqenies sociale, por edhe me institucionet tjera të shtetit. Z. Dobrushi ka kujtuar edhe bashkëpunimin e shkëlqyer dhe tri Marrëveshjet konkrete të bashkëpunimit me SBASHK-un. Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka falënderuar mikpritësin për ftesën dhe pastaj është shprehur se edhe në vitet e vrara të Kosovës, Shqipëria ishte dhe mbeti nënë për Kosovë. Ai pastaj ka renditur angazhimet e përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit vëllazëror mes Sindikatave , por edhe mes institucioneve të pushtetit të të dy vendeve.

Pjesëmarrësit kanë dëgjuar me vëmendje paraqitjet tematike të znj. Nora Malaj dhe të znj. Genta Sula që prezantonin qëndrimet dhe angazhimet e Qeverisë dhe Ministrive për ngritjen e cilësisë në arsim.

Profesori i nderuar Fatmir Bezati pastaj ka referuar në temën "Të bashkohemi për arsimin cilësor-për një botë më të mirë". Ai ka veçuar se Komisioni Evropian dhe EI-ja kanë nisur angazhimet për një strategji të përbashkët me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsim dhe se këtë Strategji do ta kenë si bazë e pikënisje që të 400 shtetet, sindikatat e të cilave janë anëtare të EI-së, pra edhe Sindikata shqiptare e arsimit dhe SBASHK-u. Kjo temë e ligjëruar qartë ka zgjuar interesimin e pjesëmarrësve të Tryezës, të cilët kanë shtruar pyetje, por edhe kanë dhënë komentet e tyre. Të angazhuar në këtë tryezë ishin edhe z.Bardh Bardhi, z.Rexhep Sadiku dhe z.Ymer Ymeri, që po përfaqësonin Arsimin Universitar, Arsimin e Mesëm dhe atë Fillor të Kosovës. Të gjithë janë pajtuar me mendimin se "Shtylla kurrizore e arsimit cilësor është mësuesi".

Sindikatat Shqiptare të Arsimit të udhëhequra nga z. Xhafer Dobrushi dhe Nevrus Kaptelli kanë zhvilluar takime me delegacionin e SBASHK- ut dhe janë pajtuar që të vazhdojnë me bashkëpunimin vëllazëror e në shërbim të arsimit dhe të punësuarve në këtë sektor tepër të rëndësishëm për Shqipërinë dhe Kosovën.

Shkolla të mos jetë vend i shpërblimit a ndëshkimit për shkak të aderimit politik

Në SBASHK ka pasur shumë vizita të palëve dhe janë marrë edhe shumë telefonata nga persona që shprehin dyshime se kanë ngelur jashtë sistemit arsimor, në të cilin kanë qenë të angazhuar me vite, për arsye të aderimit të tyre politik. SBASHK-u ka dëgjuar me vëmendje ankesat e tyre dhe uron që deklarimet e tilla të jenë produkt i ndonjë momenti emocional dhe se e vërteta qëndron ndryshe. Mirëpo ne angazhohemi për hulumtimin e secilit rast veç e veç në mënyrë që të arrijmë të e vërteta. SBASHK-u ka dyshime se në disa komuna edhe mund të kenë ndodhur raste të shpërblimit a ndëshkimit për arsye të aderimit politik të individëve. Kujtojmë DKA-të dhe përgjegjësit tjerë të pushtetit lokal nëpër Komunat e Kosovës se janë dhënë shumë deklarata nga vet ata se shkollat dhe arsimin në tërësi duhet mbrojtur nga ndikimet dhe veprimet politike, por emërimi i drejtorëve dhe zgjedhja e kuadrove arsimore nuk duket se në tërësi i ka shpëtuar kësaj. Kujtojmë po ashtu se edhe Komisioni Evropian më 3 mars 2010 ka ngritur një Strategji për ngritjen e cilësisë në arsim dhe për këtë ka obliguar të 400 Sindikatat e shteteve anëtare të EI-së (Edukimit Internacional), anëtare të cilit është edhe SBASHK-u. Është qëndrim yni se për cilësinë dhe ngritjen e saj në arsim janë DKA-të dhe MASHT-i që duhet të angazhohen në

vazhdimësi, por me ndërhyrjen e politikës dhe me kthimin e shkollave e institucioneve tjera arsimore në vende për shpërblime e ndëshkime për shkak të aderimeve politike, nuk mund të shtohet cilësia, po në të kundërtën ajo sa vjen e bie. SBASHK-u kërkon nga MASHT-i që të obligojë sektorin e Inspektimit dhe Inspektorët regjional të Arsimit që të vizitojnë DKA-të dhe të vënë në tavolinë dokumentacionin e personave të pranuar dhe të atyre që janë refuzuar në mënyrë që të vërtetohet me argumente nëse dyshimet e individëve se u është bërë e padrejtë për arsye të aderimit të tyre politik janë të sakta, apo janë vetëm deklarime të emocioneve të momentit.

SBASHK-u është i gatshëm të bëhet pjesë e ekipeve të Inspektorëve , në cilësinë e vëzhguesit, për të qenë pjesë e hulumtimit të së vërtetës. Nëse nuk veprohet nga institucionet SBASHK-u do të shkojë tutje dhe vetë do të merret konkretisht me secilin rast duke i publikuar një nga një.

Reagim i përbashkët i Sindikatës së Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (SBASHK), Sindikatës së Policisë së Kosovës dhe Sindikatës së Shëndetësisë

Në këtë takim është vendosur që këto tri Sindikata të vazhdojnë me angazhimet në kërkim të së drejtës së tyre për pjesëmarrje në përbërjen e KES-it e duke vlerësuar se BSPK-ja nuk ka të drejtë e as numër të anëtarësisë për të qenë e vetmja përfaqësuesve e punëmarrësve në Këshillin Ekonomik Social. Pasi kanë lexuar në media për vendimin e një Komisioni vlerësues për pjesëmarrje në Këshillin Ekonomik Social, përfaqësuesit e SBASHK-ut, Sindikatës së Policisë dhe asaj të Shëndetësisë, si tri degët më të mëdha Sindikale në Kosovë, kanë reaguar ndaj mendimit të këtij Këshilli, i cili pa të drejtë kishte propozuar që në KES si përfaqësues të punëmarrësve të jenë vetëm njerëz nga BSPK-ja. Duke vazhduar me angazhimet në kundërshtim të këtij propozimi dhe për ta sensibilizuar opinionin dhe organin që vendos lidhur me këtë çështje, përfaqësuesit e këtyre tri degëve janë takuar dhe kanë analizuar këtë veprim të një Komisioni, i cili brenda tij ka edhe konflikt interesi, si jo të drejtë dhe që mohon të drejtën e një pjese të madhe të të punësuarve për të pasur përfaqësuesit legjitim në KES.

Në këtë takim është vendosur që këto tri Sindikata të vazhdojnë me angazhimet në kërkim të së drejtës së tyre për pjesëmarrje në përbërjen e KES-it e duke vlerësuar se BSPK-ja nuk ka të drejtë e as numër të anëtarësisë për të qenë e vetmja përfaqësuesve e punëmarrësve në Këshillin Ekonomik Social. Sindikatat e Arsimit, Policisë dhe Shëndetësisë janë marrë vesh që çështjen ta ngrisin edhe drejt institucioneve të shtetit dhe i drejtohen publikisht Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që të mos e miratojë këtë vlerësim të Komisionit, por të veprojë sipas situatës reale dhe t'i jep të drejtën e merituar sindikatave reale dhe që kanë numrin më të madh të anëtarëve aktivë. Përfaqësusit e këtyre tri Sindikatave janë marrë vesh se çështjen bashkërisht do ta drejtojnë për në Gjykatën gjegjëse, nëse Ministria e Punës e Mirëqenies Sociale nuk degjon zërin e arsyes,

Për SBASHK-un	Për Sindikatën e Policisë së Kosovës	Për Sindikatën e Shëndetësisë
Rrahman Jasharaj,	Shaban Tasholli,	Blerim Syla

Memorandum Mirëkuptimi në mes Kolegjit “UNIVERSUM” dhe SBASHK-ut

Një delegacion i SBASHK-ut, kryesuar nga kryetari z.Rrahman Jasharaj ishte në ambientet e Kolegjit “Universum” në Prishtinë, ku në një atmosferë festive së bashku me drejtorin ekzekutiv të kolegjit z.Alejtin Berisha, kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për bashkëpunim të ndërsjellt.

Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

Me anë të këtij memorandumi, Kolegji Universum merr përsipër ofrimin e bursave të pjesërishme akademike për

anëtarët e SBASHK-ut dhe familjarët e tyre. Bursat ofrohen 30% për nivelin Baçelor për tri vite studimi dhe nivelin Master për dy vite studimi. Ata të cilët kanë përfunduar baçelor sistemin tre vjeçar atëherë studimet master zgjasin dy vite, ndërsa nëse kanë përfunduar studimet bacelor sistemin katër vjeçar atëherë studimet master zgjasin një vit.

Shuma e paraparë mund të paguhet deri me 12 këste.

SBASHK dhe Kolegji “Universum”u dakorduan që të bëjnë shkëmbimin e stafit **(në raste të caktuara)** për pjesëmarrje në ligjërata publike apo evenimente të organizuara në frymën profesionale.

Kryetari i SBASHK-ut z. Jasharaj ka falënderuar drejtorin ekzekutiv z.Berisha për marrëveshjen dhe pastaj ka njoftuar atë për angazhimet dhe arritjet e kësaj sindikate në shërbim të anëtarëve të

Marrëveshje me rëndësi për sindikalizmin në Kosovë

Pas një varg takimesh me karakter konsultativ, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës e Kulturës së Kosovës (SBASHK), Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) dhe Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK) ,në selinë e SBASHK-ut kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, bashkëveprimi dhe përfaqësimi të ndërsjellë. Nënshkruesit e kësaj marrëveshje z.Rrahman Jasharaj, z.Blerim Syla dhe z.Shaban Tasholli e kanë vlerësuar këtë moment si solemn dhe një ditë kur zëri sindikal do të jetë shumë më i fuqishëm. Me këtë Marrëveshje sindikatat nënshkruese nga sot e tutje në mënyrë unike do të bashkëveprojnë , përfaqësojnë dhe dialogojnë me bartësit e institucioneve të Republikës së Kosovë lidhur me interesat e përbashkëta të anëtarësisë së tyre sindikale.

Jasharaj, Syla dhe Tasholli kanë konsideruar se kjo marrëveshje është shembull i mirë i forcimit të unitetit dhe të zërit sindikal. Ata konsiderojnë se duke bashkëpunuar e bashkëvepruar do të jenë më të fuqishëm në realizimin e misionit të tyre dhe se më lehtë e më fuqishëm do të përballen me sfidat e kohës. Ata kanë kujtuar se këto tri sindikata janë më të fuqishmet sepse përfaqësojnë shumicën dërmuese të të punësuarve në sektorin publik të Republikës së Kosovës dhe se nga tash më fuqishëm do të mund të mbrojnë interesat dhe të drejtat sindikale, jo vetëm të anëtarësisë së tyre , por edhe të të punësuarve në sektorët tjerë.

Vazhdojnë takimet me DKA-të

Në kuadër të aktiviteteve rreth takimeve në DKA-të komunale,delegacioni i SBASHK-ut, në përbërje nga kryetari Rrahman Jasharaj, nënkryetari Lutfi Mani, anëtari i kryesisë Hajriz Berisha, kanë vizituar komunën e Prizrenit. Fillimisht u takuan me kryetarin e kuvendit të SAF dhe SAM të Prizrenit,z.Reshit Kushaj si dhe me anëtarin tjetër të kryesisë së SBASHK-ut z.Besnik Krasniqi në mënyrë që të vizitojnë bashkërisht DKA-në e kësaj komune.

Drejtori i DKA-së në këtë komunë z.Nexhat Çoçaj, mirëpriti delegacionin tonë dhe pati shumë lavdata për bashkëpunimin e DKA-së që ai drejton me sindikatën e arsimit në Prizren. Gjithashtu ai është shprehur i gatshëm të bashkëpunoj edhe në të ardhmen për arsimin në këtë komunë.

Kryetari i SBASHK-ut,z.Jasharaj e përgëzoi drejtorin z. Çoçaj për punën dhe angazhimet dhe njëkohësisht e njoftoi se SBASHK-u është duke vizituar DKA-të komunale në mënyrë që të mbrojnë Kontratën Kolektive. Sikurse në të gjitha DKA-të tjera, edhe këtu, delegacioni i SBASHK-ut kanë kërkuar që të bëhen planifikime buxhetore për zbatimin e plotë të Kontratës Kolektive, gjë që edhe kjo DKA është pajtuar me këtë propozim dhe ka shtuar se bashkëpunimin me SBASHK-un do ta vazhdoj edhe në të ardhmen.

Po të njëjten ditë, ky delegacion vizitoi edhe komunën e Dragashit, gjegjësisht DKA-në në këtë komunë. Atje u takuam me kryetarin e SAF dhe SAM z.Ajet Reshiti dhe se bashku vizituam drejtorin e DKA-së së kësaj komune, z.Hajri Ramadani

Drejtori z.Ramadani ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimin e saj për anëtarësinë e vet si dhe ka treguar se bashkëpunimi i ndërsjellë në mes të DKA-së në këtë komunë si dhe sindikatës së arsimit nuk mungon dhe do të vazhdoj edhe në të ardhmen,në të mirë të arsimit.

Edhe në këtë komunë delegacioni i SBASHK-ut ka treguar qëllimin e vizitës dhe po ashtu edhe drejtori i DKA-së në Dragash është pajtuar me propozimin për planifikim buxhetor për implementimin e plotë të Kontratës Kolektive.

Gjithashtu ai na njoftoi se edhe në komunën e Dragashit vërehet një rënie e numrit të nxënësve.

Dhe në fund të takimeve me DKA-të, delegacionin e SBASHK-ut e mirëpriti edhe Kryesia e Sindikatës së arsimit së Prizrenit, ku zhvilluam një takim pune.

Pas takimeve kishin edhe paraqitje në mediet lokale atje.